

GJYKATA SUPREME
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
04Su. Nr. 120/22
12.12.2022
SHKUP

Në bazë të nenit 20 dhe nenit 39 të Ligjit për shërbimin gjyqësor ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 43/14, 33/15, 98/15, 06/16 dhe 198/18), të Rregullores për formën dhe përmbajtjen e shpalljes interne, formën, përmbajtjen dhe mënyrën e parashtrimit të fletëparaqitjes për avancim, mënyrën e realizimit të seleksionimit administrativ dhe intervistës si dhe mënyrën e vlerësimit të tyre dhe numrit maksimal të pikëve nga procedura e seleksionimit varësisht nga kategoritë e vendeve të punës për të cilat është publikuar shpallja interne ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 275/20), Rregullores për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë, Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe pëlqimit nga Ministria e financave nr. 18-8767/2 të datës 02.09.2022

GJYKATA SUPREME
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
publikon
SHPALLJE INTERNE NUMËR 1/2022
Për avancimin në karrierë të 8 nëpunësve gjyqësorë

1. Kategoria B, niveli B - 4

Udhëheqës i Sektorit të veprave civile

- 1 realizues

Kushtet për kryerje të punëve:

Të arritura 300 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar, fakultetin juridik, me provim të dhënë të jurisprudencës.

Së paku 4 vjet përvojë pune në profesion pas provimit të dhënë të jurisprudencës.

Kandidatët krahas kushteve të theksuara më lartë, nevojitet që ti plotësojnë edhe kompetencat e posaçme të punës:

Njohje aktive të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht), njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe kompetenca të tjera të posaçme të punës të përcaktuara në aktin për sistematizim të vendeve të punës për vendin përkatës të punës, sipas nenit 2 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbimin gjyqësor ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.198/2018).

Orari javor i punës është 40 orë

Orari i punës – fillimi i orarit të punës prej ora 07,30, përfundimi i orarit të punës është në ora 15,30

Ditët e punës nga e hëna deri të premten

Neto rroga: 39.573,00 denarë

2. Kategoria B, niveli B - 4

Udhëheqës i Sektorit për gjykim në afat të arsyeshëm

- 1 realizues

Kushtet për kryerje të punëve:

Të arritura 300 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar, fakultetin juridik, me provim të dhënë të jurisprudencës.

Së paku 4 vjet përvojë pune në profesion pas provimit të dhënë të jurisprudencës.

Kandidatët krahas kushteve të theksuara më lartë, nevojitet që ti plotësojnë edhe kompetencat e posaçme të punës:

Njohje aktive të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht), njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe kompetenca të tjera të posaçme të punës të përcaktuara në aktin për sistematizim të vendeve të punës për vendin përkatës të punës, sipas nenit 2 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbimin gjyqësor ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.198/2018).

Orari javor i punës është 40 orë

Orari i punës – fillimi i orarit të punës prej ora 07,30, përfundimi i orarit të punës është në ora 15,30

Ditët e punës nga e hëna deri të premtën

Neto rroga: 39.573,00 denarë

3. Kategoria V, niveli V - 1 Këshilltar gjyqësor

- 4 realizues

Kushtet për kryerje të punëve:

Të arritura 300 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar, fakultetin juridik, me provim të dhënë të jurisprudencës.

Së paku 3 vjet përvojë pune në profesion pas provimit të dhënë të jurisprudencës.

Kandidatët krahas kushteve të theksuara më lartë, nevojitet që ti plotësojnë edhe kompetencat e posaçme të punës:

Njohje aktive të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht), njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe kompetenca të tjera të posaçme të punës të përcaktuara në aktin për sistematizim të vendeve të punës për vendin përkatës të punës, sipas nenit 3 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbimin gjyqësor ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.198/2018).

Orari javor i punës është 40 orë

Orari i punës – fillimi i orarit të punës prej ora 07,30, përfundimi i orarit të punës është në ora 15,30

Ditët e punës nga e hëna deri të premtën

Neto rroga: 32.912,00 denarë

4. Kategoria G, niveli G1

Referent i pavarur gjyqësor – në kabinetin e kryetarit të Gjykatës

- 1 realizues

Kushtet për kryerje të punëve:

Së paku arsim të lartë ose të mesëm.

Së paku 3 vjet përvojë pune në profesion.

Kandidatët krahas kushteve të theksuara më lartë, nevojitet që ti plotësojnë edhe kompetencat e posaçme të punës:

Njohje aktive të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht), njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe kompetenca të tjera të posaçme të punës të përcaktuara në aktin për sistematizim të vendeve të punës për vendin përkatës të punës, sipas nenit 4 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbimin gjyqësor ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.198/2018).

Orari javor i punës është 40 orë

Orari i punës – fillimi i orarit të punës prej ora 07,30, përfundimi i orarit të punës është në ora 15,30

Ditët e punës nga e hëna deri të premtën

Neto rroga: 22.071,00 denarë

5. Kategoria G, niveli G1

Referent i pavarur gjyqësor-realizues në Sektorin e resurseve njerëzore

1 – realizues

Kushtet për kryerje të punëve:
Së paku arsim të lartë ose të mesëm.
Së paku 3 vjet përvojë pune në profesion.

Kandidatët krahas kushteve të theksuara më lartë, nevojitet që ti plotësojnë edhe kompetencat e posaçme të punës:

Njohje aktive të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht), njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe kompetenca të tjera të posaçme të punës të përcaktuara në aktin për sistematizim të vendeve të punës për vendin përkatës të punës, sipas nenit 4 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbimin gjyqësor ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.198/2018).

Orari javor i punës është 40 orë

Orari i punës – fillimi i orarit të punës prej ora 07,30, përfundimi i orarit të punës është në ora 15,30

Ditët e punës nga e hëna deri të premten

Neto rroga: 22.071,00 denarë

Në fletëparaqitjen, kandidatët do të bashkëngjisin dëshmitë për plotësim të kushteve të posaçme dhe dëshmi për plotësimin e kompetencave të posaçme për vendin e punës edhe atë:

- Certifikatë për arsimin e kryer përkatës në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Dëshmi për përvojë pune
- Diplomë, certifikatë ose vërtetim si dëshmi për njohjen e një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht) në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter dhe
- Diplomë, certifikatë ose vërtetim si dëshmi për njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë në origjinal ose kopje të vërtetuar në Noter

Kushtet e theksuara në shpalljen, kandidatët duhet t' i përmbushin në momentin e paraqitjes
Kandidatët detyrohen që fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, në mënyrë të prerë dhe me të dhëna të sakta.

Fletëparaqitjen e plotësuar në formë të shkruar dhe dëshmitë për të dhënat që përfshihen në fletëparaqitjen, kandidatët detyrohen që përmes sportelit pranues ta dorëzojnë në Komisionin e seleksionimit për avancim.

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve është 5 ditë, llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes në Web faqen e Gjykatës.

Vërejtje: Kandidati i cili do të parashtrijë të dhëna të rrejshme do të diskualifikohet nga procedura e mëtejshme.

Procedura për seleksionim dhe avancim do të realizohet sipas Rregullores për formën dhe përmbajtjen e shpalljes interne, formën, mënyrën e parashtrimit të fletëparaqitjes për avancim, mënyrën e zbatimit të seleksionimit administrativ dhe intervistës, si dhe mënyrën e vlerësimit të tyre dhe numrit maksimal të pikëve nga procedura e seleksionimit varësisht nga kategoritë e vendeve të punës për të cilat është publikuar shpallja interne ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.275/20).